

E drejta juaj për një seancë shqyrtimi administrative

Përfitimet përfshijnë:
FIP, Triska Ushqimesh,
Medicaid, Asistencë
Shtetërore për Paaftësi,
Asistencë Shtetërore për raste
Urgjence, Asistencë për
Kujdesin e Fëmijëve dhe
Përfitimet nga Work First.

Çfarë ka ndodhur me përfitimet e mia?

Përfitimet tuaja mund të ndryshojnë për shumë arsye. Megjithatë, nëse përfitimet tuaja kanë ndryshuar ju duhet të merrni më parë njoftim me shkrim. Kur ta keni marrë njoftimin, ai duhet të përmbajë: (1) veprimin specifik të ndërmarrë nga Department of Human Services - Departamenti i Shërbimeve Njerëzore (i njohur më parë si The Family Independence Agency – Agjencia e Pavarësisë Familjare), dhe (2) arsyen për veprimin e marrë.

Ju duhet të merrni njoftim për çdo veprim ligjor që prek të drejtën tuaj për përfitime ose sasinë e përfitimeve tuaja

Si mund të kërkoj një seancë shqyrtimi?

Ju duhet të kërkonit një seancë shqyrtimi me shkrim dhe më pas ta postoni ose ta dërgoni kërkesën tek The

Family Independence Agency – Agjencia e Pavarësisë Familjare. I vetmi rast për të cilin ju mund të kërkonit seancë shqyrtimi pa bërë më parë kërkesë me shkrim është nëse ka të bëjë me ndryshimin e përfitimit në lidhje me triskat ushqimore.

The Department of Human Services - Departamenti i Shërbimeve Njerëzore duhet të marrë kërkesën tuaj për shqyrtim brenda 90 ditëve pas njoftimit të veprimit negativ të marrë me postë. Nëse dëshironi t'i mbani të pandryshuara përfitimet tuaja, ju duhet të kërkonit seancë shqyrtimi brenda 11 ditëve.

Kush mund të vijë me mua në seancën e shqyrtimit?

Një përfaqësues i autorizuar shqyrtimesh mund ta ndjekë seancën së bashku me ju. Përfaqësuesi i autorizuar i shqyrtimeve nuk ka nevojë të jetë avokat. Përfaqësuesi i autorizuar i shqyrtimeve mund të jetë kushdo i cili mund ta mbrojë çështjen tuaj. Ai apo ajo duhet të jetë i familjarizuar me normat dhe rregullat e Department of Human Services - Departamentit të Shërbimeve Njerëzore.

Çfarë ndodh në seancën e shqyrtimit?

Në seancën e shqyrtimit, ju do të jeni në gjendje t'i tregoni Gjykatësit të Ligjit administrativ pse ju mendoni se Department of Human Services - Departamenti i Shërbimeve Njerëzore nuk duhet të lejohet të ndryshojë

përfitimet tuaja. Shqyrtimi juaj mund të bëhet duke qënë personalisht i pranishëm, me Gjykatësin e Ligjit administrativ të pranishëm, ose nëpërmjet telefonit. Ju mund të sillni njerëz me vete për të dëshmuar në favorin tuaj. Gjykatësi i Ligjit Administrativ do të kryejë një incizim në kasetë të seancës, dhe do të marrë një vendim të bazuar mbi atë çfarë i thuhet atij apo asaj gjatë seancës.

A KENI NEVOJË PËR NDIHMË LIGJORE?

**A keni të ardhura të pakta?
apo jeni i moshuar?
apo keni mbijetuar dhunë shtëpiake?
apo keni mbijetuar dhunë seksuale?**

TELEFONONI:

**LAKESHORE LEGAL AID
CENTRAL INTAKE**

(Linjë Ligjore Këshillimore dhe Avokatie)

TELEFONATË FALAS: 1-888-783-8190

ST. CLAIR COUNTY OFFICE



803 Tenth Avenue, Suite C
Port Huron, MI 48060
(810) 985-5107